

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

DEKOFLOOR**PËRSHKRIMI**

DEKOFLOOR është autonivelant me bazë çimentoje sulfoaluminate me ngurtësim të shpejtë, i modifikuar me polimere dhe aditivë specialë. I projektuar për nivelimin dhe rrafshimin e sipërfaqeve të brendshme përpara vendosjes së parketit, laminateve, pllakave qeramike, vinilit, gomës dhe mbulimeve të tjera dekorative. Produkti karakterizohet nga vetënivelim shumë i mirë, rezistencë të lartë mekanike dhe punueshmëri të shkëlqyer. Ka aftësi të lartë ngjitëse me bazamentin, është rezistent ndaj shtypjes dhe gërryerjes, si dhe ofron rezistencë të lartë mekanike. I punueshëm si me dorë ashtu edhe me makineri. I klasifikuar si C30-F10-SH 30 në bazë të standardit EN 13813.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE

1. Vetënivelues me rrjedhshmëri të lartë
2. Për shtresa nga 0–15 mm
3. Rezistencë e lartë në ngjeshje dhe konsum
4. I përshtatshëm për parket dhe pllaka
5. I përshtatshëm për sisteme me ngrohje nën dysheme
6. Tharje e njëtrajtshme
7. Punim manual ose me pompë
8. Ngjitje shumë e mirë me bazamentin

FUSHA E APLIKIMIT

Autonivelues për shtresa nga 0–15 mm, i përshtatshëm për bazamente të reja dhe ekzistuese. I përshtatshëm për shtrimin e çdo tipi dyshemeje të mëvonshme, si dhe për ndërtesa me trafik të limituar. Përdoret për nivelimin e bazamenteve me bazë çimentoje, betonit, sistemit pllakë mbi pllakë dhe sipërfaqeve ekzistuese të qëndrueshme, përpara aplikimit të mbulimeve finale të dyshemesë, pasi të jetë arritur koha e nevojshme e maturimit (3–7 ditë).

TRASHËSIA DHE KOHA E THARJES***Për aplikim parketi / laminati / vinili:***

1. Trashësia minimale e rekomanduar: 3 mm
2. Koha e pritjes: rreth 3–7 ditë
3. Lagështia e bazamentit duhet të jetë <2%
4. Përpara aplikimit të autonivelantit rekomandohet astarimi i suportit me Primer D (hollimi 1:2)

Për aplikim në pllaka qeramike:

1. Trashësia e rekomanduar: 2–15 mm
2. Koha e pritjes: minimumi 48 orë, sipas trashësisë dhe kushteve atmosferike
3. Përpara aplikimit të autonivelantit rekomandohet astarimi i suportit me Beton Primer (Beton Kontakt)

PËRSHTATSHMËRIA PËR NGROHJE QËNDRORE

DEKOFLOOR është i përshtatshëm për sisteme me ngrohje qendrore dhe ngrohje nën dysheme, kur bazamenti është i qëndrueshëm dhe respektohen kushtet teknike të aplikimit

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

I rekomandueshëm për bazamente me bazë çimento, dysheme me shtresë të varfër, beton dhe sistem pllakë mbi pllakë. Duhet të sigurohet që bazamenti të jetë i pastër, pa pluhur, vajra armaturash apo çdo substancë tjetër që ndikon në reduktimin e aftësisë ngjitëse. Bazamenti duhet të trajtohet fillimisht me Primer D (hollimi me ujë 1:2) për suportet normale me bazë çimento. Në rast të suportëve me pllaka të vjetra, rekomandohet trajtimi i suportit me Beton Primer (hollimi deri në 30%).

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përzieri një thes 25 kg Dekofloor me 6 litra ujë, duke përdorur një përzierës elektrik me numër të ulët xhirosh, derisa të arrini një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni masën e krijuar në qetësi për 2–3 minuta dhe më pas bëni një përzierje të lehtë përpara aplikimit.

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

DEKOFLOOR
Date: 19.05.2026
PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përzieni një thes 25 kg Dekofloor me 6 litra ujë, duke përdorur një përzierës elektrik me numër të ulët xhiros, derisa të arrini një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni masën e krijuar në qetësi për 2–3 minuta dhe më pas bëni një përzierje të lehtë përpara aplikimit. Falë aftësisë vetëniveluese, Dekofloor eliminon në mënyrë efektive parregullsitë e vogla të sipërfaqes, duke krijuar një bazament të njëtrajtshëm dhe të përshtatshëm për aplikimet e mëvonshme. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të kontrollohet përmbajtja e lagështirës së bazamentit me një higrometër elektrik, duke pasur parasysh se ky i fundit jep vetëm vlera orientuese.

APLIKIMI

Aplikojeni produktin me një dorë të vetme, në trashësi nga 1–15 mm, duke përdorur mallë inoksi ose prej gome. Produkti mund të aplikohet edhe me pompë suvatimi. Koha e punueshmërisë së produktit është rreth 40 minuta. Përdorni rulin me gjemba për të eliminuar ajrin e bllokuar nga produkti dhe për të siguruar një sipërfaqe sa më të njëtrajtshme. Falë aftësisë vetëniveluese, Dekofloor eliminon në mënyrë efektive parregullsitë e vogla të sipërfaqes. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të kontrollohet përmbajtja e lagështirës me një higrometër elektrik, duke pasur parasysh se ky i fundit jep vetëm vlera orientuese.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thasë letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	Gri
Kokrrizimi:	0.7 mm
Konsumi:	1.6 (kg/m ²)/mm trashësi
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Trashësia:	Nga 1 në 15 mm/dorë, për parkete minimumi i shtresës që duhet aplikuar është 3 mm.
Koha e magazinimit:	6 muaj nga data e prodhimit
Ujë për përzierjen:	24%
Koha e punueshmërisë:	40 minuta
Koha e pritjes për vendosjen e pllakave:	Min 48 orë
Rezistenca në ngjeshje:	30 N/mm ²
Rezistenca në përkulje:	≥ 10 N/mm ²
I shkëlshëm pas:	12 orëve
Koha e pritjes për vendosjen e parketeve, linoleumeve, plastikës dhe gomës:	Përafërsisht 7 ditë më vonë dhe lagështia e bazamentit duhet të jetë < 2%.
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1
Forca ngjytëse pas 28 ditësh:	1.3 N/mm ²
Fortësia e sipërfaqes:	30 N/mm ²

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

DEKOFLOOR**Date: 19.05.2026****KUJDES!**

Mos e aplikoni produktin mbi bazamente metalike dhe në vende me prani lagështie, për të eliminuar rrezikun e ngritjes ose dëmtimit të bazamentit.

1. Për aplikime me trashësi më të madhe (maksimumi 20 mm), këshillohet që produkti të aplikohet në dy duar, ku dora e dytë aplikohet vetëm pas tharjes së plotë të dorës së parë, rreth 24 orë më vonë. Gjithashtu, duhet të aplikohet Primer D përpara vendosjes së dorës së dytë.
2. Vetëm për përdorim të brendshëm.
3. Mos e përdorni si shtresë finale dekorative.
4. Mos aplikoni mbi fuga lëvizëse ose sipërfaqe jo të qëndrueshme.